Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 32117
Datë/Datum. 13.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Ministria e Administratës Publike (MAP).**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.32/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën: **"Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat Qeveritare dhe kompleksin e Pallatit të Drejtësisë-Ritender,** me nr. prokurimi: **AP 202/16/005/236.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"Stewart Inspect Kosova" sh.p.k- Prishtinë**		
Datë	**13.02.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat Qeveritare dhe kompleksin e Pallatit të Drejtësisë-Ritender"** ,me nr. prokurimi: **AP 202/16/005/236** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"Stewart Inspect Kosova" sh.p.k- Prishtinë,** me nr.prot.**32/17**, e datës **30.01.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		02.02.2017		08.02.2017		13.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 30.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 32/17, e parashtruar nga operatori ekonomik: **"Stewart Inspect Kosova" sh.p.k-Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat Qeveritare dhe kompleksin e Pallatit të Drejtësisë-Ritender"**, me nr. prokurimi: AP **202/16/005/236**, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike.**
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* **"Stewart Inspect Kosova" sh.p.k-Prishtinë:**

Pikat e Ankesës:
Ne mendojmë se Autoriteti kontraktues ka bere shkelje ne dhënien e kontratës ne këto pika te LPP:

Neni 72: Dokumentacion dhe Informata Shtesë

AK ka pasur ne dokumentacion kopjen e autorizimit me numër unik te lëshuar nga MTI 005 dhe nuk e ka kërkuar dokument shtesë origjinalin ose autorizimin e noterizuar. Arsyeja e mos dorëzimit ka qene teknike, ne jemi kompani e vogël, dhe un si pronar kam pas probleme shëndetësore se jam i sëmur kronik nga 2104 me një lloj te tumorit.

Neni 59: Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimi i Tenderëve:

AK nuk ka kërkuar si dokument shtesë kopjen e noterizuar duke ditur se një dokument i tillë ka qene vetëm gabim teknik dhe nuk ndikon ne çmimin e tenderit

Neni 60: Kriteret për Dhënie te Kontratës

Kemi qene OE me çmimin me te ulet dhe kemi plotësuar te gjitha kërkesat, AK ka shpërblye me kontratë një tjetër OE i cili ka ofertua me çmimin me te larte.

Neni 1: Qëllimi

AK nuk ka pasur për qellim shfrytëzimin e fondeve publike (1), nuk ka qene transparent (2) dhe ka qene i ndikuar (3)

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Nuk është bere përdorimi ekonomik i fondeve publike sepse është shpërblye me kontratë OE me çmim me te larte

Neni 7: Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi

AK nuk na ka trajtua si te barabartë sepse qëllimi ka qene eliminimi nga aktiviteti i prokurimit. Ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar te çilen e kemi marr nga AK pas insistim nga ana jone pas publikimit te njoftimit mbi denje e kontratës ne portalin e KRPP-së. AK ne arsyet mbi eliminim përveç kopjes se pa noterizuar gjithashtu thotë se ne nuk kemi dorëzuar edhe kopjen e certifikatës se TVSH-së dokument i cili nuk është kërkuar ne dosjen e tenderit.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Me datën 12.01.2017 ne portalin e KRPP-së ka dal njoftimi mbi dhënie e kontratës OE EALGA, dhe një njoftim i tillë mbanë datën e përgatitjes se njoftimit 10.01.2017.(DOK 1) Po me ketë date 12.01.2017. i drejtohemi AK përmes postes elektronike qe te na informojnë zyrtarisht mbi eliminimin nga procedurat e prokurimit (DOK 2). Po te njëjtën dite nga AK marrim letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (DOK 3) e cila mban datën 12.01.2017, qe do te thotë se kjo letër është përgatit dy dit pasi qe është përgatitur njoftimi mbi denje e kontratës dhe kjo na është dërguar vetëm pas kërkesës nga ana jone. Ne arsyetimin ne letrën standarde shkruan se jemi eliminuar se nuk kemi ofruar autorizimin origjinal ose kopjen e noterizuar dhe nuk kemi ofruar Certifikatën e TVSH-se e cila nuk është kërkuar ne dosjen e tenderi (DOK 4). Me datën 13.01.2017, përmes postes elektronike jemi drejtuar AK me kërkesën për rishqyrtim te tenderit (DOK 5). Me datën 16.01.2017, AK na ka informuar mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit (DOK 6), ndërsa me 18.11.2017 përsëri AK na njofton se e zgjat afatin për rishqyrtimin e ankese edhe për tri dite (DOK 7). Me datën 20.01.2017 AK na informon se ankesajone është e pa bazuar (DOK 8)

Ne kërkesën tone për rishqyrtim ne si OE kemi parashtruar 3 pika:

1. Jemi te vetëdijshëm se nuk e kemi dorëzuar autorizimin e as kopjen origjinal, për arsye se koha ka qene e shkurtër, dhe pasi qe kompania ka stafte vogël se merremi vetëm me kontrollime teknike te ashensorëve konform UA 09/2012 Mbi ashensorët dhe komponentët e tyre te sigurisë, te nxjerre nga Ministria e tregtisë dhe industrisë (MTI), ne baze te cilit ne jemi autorizuar, un si pronar i kompanisë Vuaj nga 2014 me një sëmundje kronike -Kancer, ka qene e pa mundur te bej noterizimin. Ne përvojën e me hershme me AK- MAP, për një procedurë te ngjashme te prokurimit AK ka kërkuar dokumente shtesë kërkesë për shtyrjen e validitetit te ofertës (DOK 9 dhe 9.1), kërkesë për deklarim te mbajtjes se përgjegjësisë (DOK 10 dhe 10.1) dhe kërkesë për takim (DOK 11) dhe pas plotësimit te kërkesave te parashtruara nga AK, është ndërprerë procedura e prokurimit edhe pse ne si OE kemi ofruar me vlere 4000 euro, ndërsa OE i cili tash është shpërblye me kontratë ka pas ofertë prej 7600 euro.

2. Nuk kemi dorëzuar certifikatën e TVSH-se se nuk jemi deklarues te TVSH, sepse nuk kemi arritur limitin e kërkuar nga ATK-se, sepse veprimtaria jone është komfor UA 09/2012 te lëshuar nga MTI, gjithashtu nuk është kërkuar ne dosjen e tenderit (DOK 4), (shih dosjen e tenderit faqe 6)

3. AK shpërblen me kontratë një OE i cili nuk është i autorizuar ne dy pika sipas UA 09/2012 ne baze te se cilit ka marr autorizimin. Ne dosjen e tenderit ne specifikat teknike (shih dosjen e tenderit nga faqe 47 deri 51 ne rubriken Data e kontrollit te fundi shenon se nuk kemi shenime) shkruan se për 11 ashensor nuk posedojnë asnjë shënim dhe sipas UA 09/2012, nuk mund te kontrollohet periodikisht një ashensor nëse nuk ka certifikatë te konformitetit (aneksi X). Ndërsa ne Shkresën e AK thuhet se te gjithë

ashensorët janë te certifikuar me herët e cila bije ne kundershtim me dosjene tenderit (DOK 4).

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....05.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....koutim i çmimit
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Shërbime/koutim i çmimit
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 12.12.2016

Data e hapjes së ofertave (N.58):.....12.12.2016
Data e njoftimit për dhënien e kontratës.....10.01.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	LOT	Çmimi	Vërejtje
1	"Copron-I"	Prishtinë	-	19,600.00€	JO
2	"Ealga"	Prishtinë	-	9,499.00€	JO
3	"Stewart Inspect"	Prishtinë	-	9,290.00	JO
4	"GMC Kosova"	Prishtinë	-	9,766.86	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë kater (4) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
Kërkesat :

a. **Deklaratë nën betim** - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.
b. **Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore** e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

a. **Deklaratë nën betim** (Origjinali).
b. **Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore** –

Dokumentet **(nën b)** duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fitues,** para publikimit të dhënies së

kontratës. Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat :

a) **Certifikata e regjistrimit të biznesit** e lëshuar nga MTI, ose regjistrimin e biznesit nga vendi i themelimit të ofertuesit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë);

b) **Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal** (për Kompanitë Kosovare).

Dështmia e kërkuar dokumentare

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- (kopje).
b. Certifikatën me numër fiskal (kopje).

Kërkesa(t) për secilin anëtar të grupit në rast se tenderuesi është grup i operatorëve ekonomik:

Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, nga grupi kërkohet që të emërojë njërin nga anëtarët e grupit, si operator për kontakt dhe, së bashku me tenderin e tij, të dorëzojë edhe origjinalin e nënshkruar të marrëveshjes për krijimin e atij grupi ne pajtim me nenin 71 të LPP-së 04/L042.

Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të LPP-së nr. 04/L042 do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

N/A.

III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesat

Autorizim origjinal ose kopje e noterizuar për certifikim .

OE duhet të ketë së paku dy kontrata të përfunduara me sukses në tri vitet e fundit (2013,2014,2015)

Dështmia e kërkuar dokumentare

Licenc valide nga MTI , për certifikim të ashensorëve

Lista e Projekteve, referencave të punëve të përfunduara në tri vitet e fundit (2013,2014,2015) minimumi 2 referenca për shqyrtim të ashensorëve.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Armend RUGOVA: Kryesues,
Bekim BLAKAJ: Anëtar,
Esat MULIQI; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 10.01.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit te ofertave pas shqyrtimit te teresishem te dokumentacionit me te cilin ka disponuar, duke u bazuar ne kriterin per dhënien e kontrates te përcaktuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit (Tenderi i pergjegjshem me çmim me te ulet), konstaton se OE "EALGA" – Prishtinë, te shpërblehet me kontrate me çmim te ofertes ne hapje prej 9,499.00€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për furnizim, vlerë e madhe, e ndarë në lote, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 05.08.2016, për këtë aktivitet të prokurimit Lot-2 dhe Lot-4, OE ankues në konzercium: "Beni Dona Plast & ABB & Alpina & Shendi"sh.p.k, fillimisht ka parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 15.08.2016, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:
Neni 1, i LPP-së, (Qëllimi),
Neni 6, i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe efikasiteti),
Neni 7, i LPP-së, (Barazia në trajtim/Jo Diskriminimi),
Neni 59, i LPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve),
Neni 72, i LPP-së, (Dokumentacioni dhe informata shtesë),

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket arsyes të eliminimit të OE ankues në lidhje me kërkesën për autorizim origjinal apo kopje e noterizuar,

Eksperti shqyrtues, në lidhje me këtë vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor pasi që Autoriteti kontraktues ka vlerësues në bazë të kërkesës së FDT-së dhe njoftimit për kontrat, për faktin se OE ankues ka ofruar autorizim kopje të panoterizuar, ndërsa në dosjen e tenderit kërkesa ka qenë e qartë ku është kërkuar autorizim origjinal apo kopje e noterizuar. Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues nuk e ka parë të nevojshme kërkesën për informata shtesë në lidhje me nenin 72 të LPP-së, pasi që kërkesa ka qenë e qartë dhe OE ankues nuk ka arritur të plotësoj me kohë.

Pretendimi ankimor nr.2
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket arsyes të eliminimit të OE ankues në lidhje me kërkesën për çertifikaten e TVSH-së,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimore për faktin se Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59.4 të LPP-së, gjatë ekzaminimit vlerësimit të ofertave duke u bazuar në atë se në dosjen për koutim të çmimit tek kërkesat për përshtatshmëri profesionale NUK është kërkuar certifikata e TVSH, dhe njëherit konstatojm se kemi përpilimi i dosjes së koutimit të çmimit është në kundërshtim me nenin 27, paragrafi 4 të LPP-së, pasi që në dosje NUK janë kërkesat identike me njoftimin për kontrat, sepse certifikata e TVSH në dosjen e koutimit NUK është kërkuar, ndërsa në njoftimin për kontrat është kërkuar.

Pretendimi ankimor nr.3
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket plotësimit të specifikimit teknik, konkretisht kontrollit të ashensorëve, Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontrat NUK plotësuar të dhënat me shenime sipas kërkesës të specifikimit teknik ku është kërkuar data kontrollit të fundit, dhe njëherit qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë pikë.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të bazuar, ankesën e OE ankues "Stewart Inspect Kosova"sh.p.k, me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit: "Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat Qeveritare dhe kompleksin e Pallatit tè Drejtësisë-Ritender", me nr. prokurimi: AP 202/16/005/236, dhe njëherit të ANULOJ, këtë aktivitet të prokurimit në bazë të nenit 62 të LPP-së, pasi që kriteret e kërkuara në dosje NUK janë identike në Njoftimin për kontrat siç parashihet në nenin 27.4 të LPP-së.